




Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*  
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministristvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*



REPUBLIKA E KOSOVËS  
KOMUNA GLOGOC  
MUNICIPAL GLOGOC

01/ Nr. 400/21-7909  
Më  
On. 12/02/2019

Prishtinë, 28.01.2019  
Nr. 45/2019

Në mbështetje të nenit 4, 21 dhe 22 të Ligjit Nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare, Nr. 82, 21 tetor 2010), nenit 8 paragrafi 1.4, të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenin 5 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale.

Në pajtim me Marrëveshjen në mes të MAPL-së, Komunës së Glogocit dhe Helvetas Swiss Intercooperation për pjesëmarrje në grantin e Përfomancës të nënshkruar me datën 20.03.2018,

lidhet kjo:

## MARRËVESHJE PËR BASHKËFINANCIM TË PROJEKTIT

### Palët nënshkruese

1. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal përfaqësuar nga Ministri i MAPL (në tekstin e mëtejme MAPL),
  2. Helvetas Swiss Intercooperation përfaqësuar nga Drejtori i projektit DEMOS (në tekstin e mëtejme DEMOS)
- dhe,
3. Komuna e Glogocit përfaqësuar nga Kryetari i Komunës, (në tekstin e mëtejme Komuna).

### Neni 1 - Qëllimi

1. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), në partneritet me Zyrën Zvicerane për Bashkëpunim (SDC), Agjencin Suedeze për zhvillim dhe bashkëpunim ndërkombëtar (Sida), zhvilluan dhe u pajtuan të bashkëfinancojnë Grantin e performancës.
2. Qëllimi i Grantit të performancës është stimulimi i komunave për përmirësimin e mëtutjeshëm të performancës së tyre në fushat e qeverisjes demokratike, menaxhimit komunal dhe transparencës dhe integritetit.

3. Kjo marrëveshje është për bashkëfinancim të projektit në vijim si dhe përcaktimin e obligimeve të palëve nënshkruese:

- Ndërtimi i kolektorëve për grumbullimin e ujërave të zeza në Glllogoc

## **Neni 2 - Vlera e projektit dhe mënyra e financimit**

1. Shuma totale e projektit është në vlerë para llogaritave prej 480,000.00 €.
2. Kontributi i Grantit të performancës (pjesa e DEMOS), për këto projekte është 183,439.00 €.
3. Kontributi i Komunës së Glllogocit, për këto projekte është 296,561.00 €.

## **Neni 3 - Obligimet e MAPL**

1. MAPL bashkëfinancon Grantin e performancës me 50% për 4 vite (2018-2021).
2. MAPL zotohet se, në bashkëpunim me DEMOS dhe ministritë përkatëse, do të krijoj mekanizma për bartjen sa më të lehtë të mjeteve të komuna.
3. MAPL nuk merr asnjë përgjegjësi për zbatim të projekteve të bashkëfinancuara me këtë marrëveshje dhe as nuk bart ndonjë pasojë në rast të ndryshimeve eventuale të çfarëdo natyre apo shkeljeve të mundshme gjatë zbatimit të projekteve.

## **Neni 4 - Obligimet e DEMOS**

1. DEMOS bashkëfinancon Grantin e performancës me 50% për 4 vite (2018-2021).
2. DEMOS zotohet se, në bashkëpunim me MAPL dhe ministritë përkatëse, do të krijoj mekanizma për bartjen sa më të lehtë të mjeteve të komuna.
3. DEMOS do të trasferoj te komuna pjesën e vet të kontributit në Grantin e performancës në vlerën e përcaktuar në nenin 2.2 më lartë.
4. DEMOS nuk merr asnjë përgjegjësi për zbatim të projekteve të bashkëfinancuara me këtë marrëveshje dhe as nuk bart ndonjë pasojë në rast të ndryshimeve eventuale të çfarëdo natyre apo shkeljeve të mundshme gjatë zbatimit të projektit.

## **Neni 5 - Obligimet e Komunës**

1. Komuna është e obliguar që pas pranimi të kësaj Marrëveshjeje të nënshkruar dhe të protokolluar të hartoj projektet zbatuese si dhe të zhvilloj tërë dokumentacionin e nevojshëm që projektet të mos kenë pengesa në realizim.
2. Komuna obligohet që të zhvilloj projektet në pajtim me kornizën ligjore në fuqi në Republikën e Kosovës.
3. Komuna obligohet të zotoj kontributin e vet për zbatim të projekteve në vlerën e përcaktuar në nenin 2.3 më lartë.
4. Nëse shuma e projektit, pas procedurave të prokurimit, është me e vogël se paralogaria e përcaktuar në nenin 2.1 më lartë, Komuna obligohet të zvogëloj kontributin e vet, ndërsa pjesa e Grantit të performancës mbetet e njëjtë sikur është përcaktuar në nenin 2.2 më lartë.
5. Komuna obligohet që të informoj DEMOS dhe MAPL për vlerën finale të projekteve të bashkëfinancuara me këtë marrëveshje pas përfundimit të procedurave të prokurimit.
6. Komuna obligohet të dërgoj në DEMOS dhe MAPL nga një kopje të pranimi teknik si konfirmim zyrtarë i përfundimit të projekteve.
7. Çdo ndryshim eventual i listës së projekteve apo i ndryshimeve sasiore apo cilësore të projekteve të bashkëfinancuara me këtë marrëveshje obligon komunën për pasojat të çfarëdo natyre qofshin ato.
8. Komuna duhet të ndërmerr të gjitha masat që projektet të përfundojnë gjatë vitit buxhetor 2019. Në rast se projektet nuk përfundojnë gjatë vitit buxhetor 2019, Komuna mund të bartë mjetet e pa shpenzuara të Grantit të performancës në vitin 2020 për vazhdimin e projekteve sipas neni 1 të kësaj marrëveshjeje.

## **Neni 6 - Pronësia e projektit**

1. Me pranim dorëzimin e punëve të kryera nga ana e Komunës dhe operatorit ekonomik respektivisht, projektet e bashkëfinancuara me këtë marrëveshje do të kalojnë në pronësi të Komunës.
2. Komuna obligohet të regjistroj projektet në pronësi të komunës në mënyrë elektronike dhe fizike, në sistemin e pasurisë në Ministrinë e Financave (SMIFK).

## **Neni 7 - Ndryshimet dhe ndërprerja e marrëveshjes**

1. Me pëlqim paraprak të DEMOS, MAPL dhe Komunës marrëveshja mund të ndryshohet dhe të plotësohet.
2. DEMOS dhe MAPL kanë të drejtën e ndërprerjes së marrëveshjes në rast se konstaton se Komuna nuk i përmbush obligimet e veta të dala nga kjo marrëveshje.

## **Neni 8 - Zgjidhja e mosmarrëveshjes**

1. Palët janë pajtuar që mosmarrëveshjet të zgjidhen me mirëkuptim.

### Neni 9 - Hyrja në fuqi

1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit të saj nga MAPL, DEMOS dhe Komuna.
2. Marrëveshja është e nënshkruar në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe në tre (3) kopje origjinale, nga një kopje për secilën palë nënshkruese.
3. Interpretimi në gjuhën angleze mbizotëron.

  
Ivan Todosijević  
Ministër i MAPL

  
  
Norbert Pijls  
Drejtör i DEMOS

  
  
Ramiz Lladrovci  
Kryetar i Komunës së Glogocit